



EJA NË UNION, RRITE BIZNESIN TËND!

Rrjetëzohu përmes Unionit me shumë biznese nga **Gjermania** dhe **Kosova**!

PËRMBAJTJA

- Fjala e kryetarit 2
- Aktivitetet e UBSHGJ 4
- Statistika/Kosovë 6
- Statistika/Gjermani 10
- Përfitimet e anëtarëve 13
- Arsyet për të investuar në Kosovë 14
- Profili i anëtarëve 15

“Gjërat e mëdha në biznes nuk janë bërë kurrë nga një person, ato janë bërë nga një grup njerëzish”.

Steve Jobs



FJALA E KRYETARIT



Një dekadë e suksesshme dhe një vizion i ri për dekadën e re

Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane është një platformë e suksesshme e bashkëpunimit dhe zhvillimit të bizneseve anëtare të tij. Me rastin e shënimit të një dekade veprimtari, me krenari mund ta kthejmë kokën prapa dhe t'i shohim rezultatet e arritura deri më tani. Ashtu siç, falë vizionit tonë të qartë për të ardhmen, me entuziazëm mund të shohim përpara, ku na presin rezultate e suksese edhe më të mëdha.

Gjatë kësaj periudhe, ne kemi arritur rritjen e shumë kompanive shqiptare në Gjermani e Kosovë, kemi mundësuar dhe lehtësuar bashkëpunimin midis tyre, kemi kontribuar në nxitjen e investimeve direkte në Kosovë, kemi ndihmuar kompanitë me bazë në Kosovë të eksportojnë produktet e tyre në tregun gjerman, kemi ndihmuar vendin në kohë fatkeqësish, kemi kontribuar në edukimin e të rejave dhe të rinjve përmes ndarjes së bursave, i kemi ndihmuar gratë në biznes (si përmes mbështetjes financiare ashtu edhe përmes hapjes së kanaleve për eksport të produkteve të tyre), kemi ndihmuar aftësimin profesional të të rinjve nga Kosova përmes mundësimit të shkollimit profesional trevjeçar në Gjermani etj. Pra, e kaluara jonë është pasqyrë e krenarisë sonë, por ne nuk do të ndalemi këtu. Së fundmi e kemi miratuar strategjinë e re të veprimit dhe i jemi futur procesit të reformimit të organizatës.

Tani jemi duke jetuar në epokën e digjitalizimit. Përshtatja me të është një sfidë, por ne jemi të prirë ta shohim atë si një mundësi. Madje, mundësi të jashtëzakonshme për të ndryshuar mënyrën se si operojmë. Do t'i përdorim përparësitë që ofron teknologjia në përparimin e bizneseve tona anëtare, vendeve tona të origjinës dhe vendit ku operojmë. Kjo do të na ndihmojë të rrisim cilësinë e shërbimeve tona dhe të ofrojmë një përvojë më të mirë bashkëpunimi. Gjithashtu, përmes digjitalizimit, sigurohemi që të gjithë anëtarët tanë të kenë mundësi të barabarta, pavarësisht nga vendi ku veprojnë ata.

Në këtë moment të veçantë dua t'i falënderoj, një nga një, të gjithë anëtarët dhe ata që në çfarëdo mënyre kanë kontribuar në themelimin dhe zhvillimin e Unionit. Gjithashtu, u bëj thirrje edhe kompanive të tjera që të na bashkohen në këtë rrugë të suksesit për të gjithë ne. Së bashku, ne mund të bëjmë ndryshime të mëdha. Le të vazhdojmë të punojmë me entuziazëm dhe përkushtim për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për të gjithë.

Miqësisht,

Nazmi Viqa, Kryetar i Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane



ME KËNAQËSI MIRËPRET

ANËTARËT E RI TË UNIONIT TË BIZNESEVE SHQIPTARO-GJERMANE

PREMIUM





ME KËNAQËSI MIRËPRET

ANËTARËT E RI TË UNIONIT TË BIZNESEVE SHQIPTARO-GJERMANE

PREMIUM

LIRIDONI



PROTEC
HIGH TECH PERFORMANCE



KAHN&Z
ARCHITECTS



IZOVENT
• VENTILIM • KLIMATIZIM • TERMOIZOLIM



GOLD

ALBED



rikon



**Banka
Ekonomike**



MODEL SLOVENIA
MODEL SLOVENIA



BRONZE

LEONI
GROUP





AKTIVITETET E UBSHGJ

Përfaqësues të UBSHGJ vizitojnë kompaninë “Binni Sh.P.K”

Kryetari i Unionit të Bizneseve Shqiptaro – Gjermane, Nazmi Viqa, së bashku me përfaqësuesit e shoqatës, vizituan kompaninë e mirënjohur në fushën e mobilierisë, “BINNI” Sh.P.K.

Përfaqësuesit e Unionit u pritën në takim nga Nexhat Fazliu, drejtori i kompanisë “BINNI”, i cili i njoftoi ata për së afërmi me procesin e prodhimit të dyerve, dritareve dhe produkteve të tjera në kuadër të kësaj fushe. Ai foli edhe për historikun e



themelimit dhe zhvillimit të kompanisë ndër vite, duke filluar nga viti 1989, historik që mbizotërohej nga fryma e punës së palodhshme, sakrificës, korrektësisë, kreativitetit dhe synimit për të arritur standardet më të larta.

Kryetari i UBSHGJ-së e përgëzoi atë për arritjet e mëdha dhe u shpreh se vetëm me një angazhim e investime të tilla mund t’i ndihmohet zhvillimit ekonomik të vendit dhe krijimit të perspektivës për të rejtat e të rinjtë tanë.

Drejtori Fazliu, duke e vlerësuar rëndësinë e bashkimit të potencialit ekonomik e njerëzor në organizata të tilla si Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane, shprehu

gatishmërinë që të bëhet pjesë e tij, me ç’rast, kryetari Viqa edhe zyrtarisht ia dorëzoi certifikatën e anëtarësimit, e falënderoi atë dhe uroi për suksese në këtë rrugë të përbashkët!



UBSHGJ u ndan mirënjohje bizneseve për kontributin ndaj shoqatës

Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane mbajti takim me strukturat dhe disa nga anëtarët premium të tij. Takimi u mbajt në Koblenz të Gjermanisë.

Takimin e hapi kryetari i UBSHGJ, Nazmi Viqa, me ç’rast i njoftoi të gjithë të pranishmit se qëllimi i takimit ishte falënderimi i të gjithë atyre që po japin kontribut në

zhvillimin dhe rritjen e Unionit të Bizneseve.



Në takim ishte i pranishëm edhe Lazim Destani, afarist i mirënjohur shqiptar me nam ndërkombëtar, i cili në fjalën e tij përshëndetëse shprehu nevojën e inkurajimit të bashkatdhetarëve tanë që jetojnë dhe veprojnë në diasporë për të marrë guximin që të bëhen ndërmarrës.

Kontribuuesve të pranishëm, kryetari Viqa u ndau mirënjohje në shenjë falënderimi për kontributin ndaj shoqatës.

UBSHGJ viziton kompaninë anëtare “PROTEC”

Kryetari Nazmi Viqa, i shoqëruar nga ekipi i tij, vizitoi kompaninë “Protec” nga Gjilani, anëtare e Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane.

Përfaqësuesit e Unionit u pritën nga pronari i kompanisë, Xhemail Shabani. Ai, pasi i falënderoi për vizitën, i njoftoi ata me aktivitetet dhe punën që bëhet në fabrikën e tij.



Kryetari Viqa, po ashtu e falënderoi pronarin e fabrikës për mikpritjen dhe shprehu zotimin që Unioni do të qëndrojë gjithmonë afër anëtarëve të vet dhe do t'i mbështes ata me të gjitha kapacitetet e tij.

Fabrika “PROTEC” ka përvijë të gjatë mbi 25 vjeçare në prodhim. Përveç projekteve vendore, rreth 40% të prodhimit të saj e ka të orientuar në eksport.

Kryetari i Junikut priti në takim përfaqësuesit e Unionit

Kryetari i Komunës së Junikut, Ruzhdi Shehu, priti në takim kryetarin e Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane, Nazmi Viqa, të shoqëruar nga nënkryetari, Zenun Krasniqi dhe një pjesë e kryesisë.

Kryetari Shehu, duke falënderuar Unionin e Bizneseve për përkrahjen dhe kujdesin e



vazhdueshëm ndaj vendlindjes, shprehu gatishmërinë që të ofrojë të përkrahjen e tij të plotë në shërbim të krijimit dhe forcimit të bashkëpunimit midis bizneseve nga kjo komunë dhe anëtarëve të Unionit në Gjermani. Gjithashtu, ai shprehu interesin dhe mbështetjen e komunës që ai e drejton për investime direkte nga bizneset e diasporës.

Kryetari Viqa, e falënderoi Kryetarin e Junikut për mikpritjen, e njoftoi atë lidhur me objektivat dhe aktivitetet aktuale të UB-së, si dhe angazhimin e vazhdueshëm të Unionit në ndërtimin e urave të bashkëpunimit midis bizneseve nga vendlindja me ato të diasporës.

STATISTIKA / KOSOVË

Bruto Produkti Vendor (BPV) në TM2 të 2023

Aktivitetet ekonomike që kishin rritje në këtë tremujor ishin: artet, argëtimi dhe çlodhja, aktivitetet e prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe shërbime të tjera (5,77%); aktivitetet shkencore, profesionale dhe teknike; aktivitetet e shërbimeve administrative dhe mbështetëse (5,05%); aktivitetet financiare dhe të sigurimit (3,66%); bujqësia, pyjet dhe peshkimi (2,81%); ndërtimtaria (2,70%); tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave; transporti dhe magazinimi; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor (2,38%); aktivitetet e pasurive të paluajtshme (2,15%); informacioni dhe komunikimi (2,02%).

TERMI i këtij numri

BRUTO PRODUKTI VENDOR - BPV (GDP) /

Bruto Produkti Vendor (BPV) është një nga matjet më të përdorura për matjen e ekonomisë së një vendi. Përkufizohet si vlera totale e mallrave dhe shërbimeve të prodhuara brenda kufijve të një vendi në një periudhë specifike. Me produkt nënkuptohen vetëm mallrat dhe shërbimet finale. Varësisht se a merret parasysh ndryshimi i çmimeve nga viti në vit apo jo, dallojmë BPV nominale dhe BPV reale.

BPV nominale apo BPV me çmimin aktual

BPV nominale është Bruto Produkti Vendor i një vendi në një viti të caktuar, i vlerësuar në bazë të çmimit të mallrave dhe shërbimeve të të njëjtit vit. Formula për përcaktimin e BPV-së nominale të një vendi është:

$$\text{BPV nominale} = \frac{\text{BPV reale} \times \text{Indeksi i çmimit}}{100}$$

BPV reale apo BPV me çmim konstant

BPV reale është Bruto Produkti Vendor i një vendi në një viti të caktuar, i vlerësuar në bazë të çmimit të mallrave dhe shërbimeve të një viti të përcaktuar si vit bazë. Formula për përcaktimin e BPV-së reale të një vendi është:

$$\text{BPV reale} = \frac{\text{BPV nominale}}{\text{Çmimi i indeksit}} \times 100$$


Pra norma reale, ndryshe nga norma nominale e rritjes së BPV-së, në matjen e rritjes ekonomike e zbret inflacionin.

BPV u mundëson politikëbërësve dhe bankave qendrore të gjykojnë nëse ekonomia po tkurret apo po zgjerohet dhe të ndërmarrin menjëherë veprimet e nevojshme.



Komponentët e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve që kishin rritje ishin: eksporti i shërbimeve (13,62%); importi i mallrave dhe shërbimeve (6,29%); shpenzimet e konsumit final të Qeverisë (3,96%); shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe IJPSHESH (3,68%); formimi i bruto kapitalit (2,04%). Ndërsa rënie kishte: eksporti i mallrave (-10,67%).

Rritja reale e BPV-së tremujore krahasuar me periudhën përkatëse të vitit paraprak:



(Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës)

NDIKIMI I INTELIGJENCËS ARTIFICIALE (IA) NË VENDET E PUNËS

Sipas raportit të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), njoftohet se 27% e vendeve të punës në vendet e zhvilluara mbështeten në aftësi që mund të automatizohen lehtësisht përmes Inteligjencës Artificiale (IA). Sipas OECD-së, më së shumti pritet të preken profesionet që kërkojnë aftësi më të larta. Ndërsa, në raportin e tij, Goldman Sachs vlerëson se rreth 300 milionë vende pune mund të ndikohen nga IA, që do të thotë se 18% e punës në nivel global mund të automatizohet. Ky revolucion teknologjik pritet t'i godas më shumë ekonomitë e zhvilluara sesa ato në zhvillim. Sipas raportit, vendet e punës në bujqësi, miniera dhe prodhim janë më pak të ekspozuara ndaj IA. Ndërsa më të ekspozuarat pritet të jenë punët që përdorin "aftësi programimi dhe shkrimi".

Tregtia e jashtme

Eksporti sipas Klasifikimit Standard të Tregtisë së Jashtme (KSTJ)

1000 euro

Viti/Muaji	Gjithsej	Ushqime dhe kafshë të gjalla	Pije dhe duhan	Materiale të papërpunuara	Lëndë djegëse	Yndyra bimore dhe shtazore
2023/01	62,175	5,834	2,709	8,038	4,571	513
2023/02	73,170	5,311	3,212	9,994	8,142	693
2023/03	81,776	6,876	3,726	10,209	3,142	860
2023/04	67,299	4,832	3,407	8,359	3,062	1,043
2023/05	74,779	5,592	4,899	9,927	3,414	819
2023/06	68,573	7,577	4,038	6,994	2,457	652

(Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës)

Eksporti sipas destinacionit

1000 euro

Viti/Muaji	Gjithsej	28 vendet e BE-së	CEFTA	EFTA	Vendet tjera evropiane	Vendet tjera joevropiane	Vendet nga Azia	Të tjera
2023/01	62,175	19,771	25,966	6,320	2,921	5,094	3	2,100
2023/02	73,170	23,533	27,275	5,882	3,038	8,469	134	4,839
2023/03	81,776	28,059	32,038	6,462	3,488	10,170	126	1,433
2023/04	67,299	19,532	27,003	6,377	3,215	9,944	97	1,130
2023/05	74,779	21,851	33,145	5,936	3,339	8,854	77	1,577
2023/06	68,573	22,875	27,919	6,766	2,450	7,154	32	1,378

(Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës)

Importi sipas Klasifikimit Standard të Tregtisë së Jashtme (KSTJ)

1000 euro

Viti/Muaji	Gjithsej	Ushqime dhe kafshë të gjalla	Pije dhe duhan	Materiale të papërpunuara	Lëndë djegëse	Yndyra bimore dhe shtazore
2023/01	353,720	58,543	13,262	3,072	57,681	2,290
2023/02	390,688	66,943	15,166	4,392	43,619	2,295
2023/03	508,580	86,682	19,320	7,054	65,183	3,249
2023/04	448,259	79,221	16,913	4,786	56,284	3,888
2023/05	518,125	81,584	23,435	6,833	60,556	3,090
2023/06	467,380	81,129	22,599	10,557	49,471	2,767

(Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës)

Importi sipas KSTJ (vazhdim)

1000 euro

Viti/Muaji	Produkte kimike	Mallra të përpunuara	Makineri e pajisje transporti	Materiale tjera të papërpunuara	Mallra të paklasifikuara diku tjetër
2023/01	37,367	71,115	71,881	38,259	248
2023/02	45,117	74,537	89,209	46,951	2,459
2023/03	66,758	101,300	101,419	57,156	459
2023/04	54,431	92,583	92,006	47,975	172
2023/05	59,132	107,016	116,886	59,146	446
2023/06	52,926	98,360	101,806	47,293	472

(Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës)



Importi sipas vendit të origjinës

1000 euro

Viti/Muaji	Gjithsej	28 vendet e BE-së	CEFTA	EFTA	Vendet tjera evropiane	Vendet tjera joevropiane	Vendet nga Azia	Të tjera
2023/01	353,720	149,305	54,464	2,309	53,598	10,512	54,905	28,626
2023/02	390,688	173,163	61,737	3,612	60,811	10,457	57,248	23,659
2023/03	508,580	228,137	92,557	4,037	78,816	15,816	63,494	25,722
2023/04	448,259	199,545	78,345	3,355	70,977	10,463	65,194	20,379
2023/05	518,125	215,254	96,824	4,136	81,947	12,906	82,199	24,858
2023/06	467,380	199,609	72,461	3,041	73,935	13,227	76,360	28,747

(Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës)

STATISTIKA / GJERMANI

Bruto Produkti Vendor (BPV)


Specifikacioni	Njësia	2022	2022				2023	
			TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2
Bruto Produkti Vendor (BPV)								
çmimi i rregulluar ¹	%	1.8	4.3	1.6	1.2	0.2	0.1	-0.6
çmimi dhe kalendari i rregulluar ²	%	1.9	1.0	-0.1	0.4	-0.4	-0.1	0.0
me çmimet aktuale	Euro billion	3,876.8	943.3	950.3	976.6	1,006.6	1,005.6	1,012.1
për banor ³	Euro	46,264	11,341	11,341	11,623	11,955	11,915	11,985
për personat në punë	%	0.4	2.7	0.0	0.0	-0.9	-0.8	-1.4

¹ Ndryshimi i vitit të kaluar ose i njëjti tremujor i vitit paraardhës në %.

² Ndryshimi i vitit ose tremujorit të mëparshëm në %. Për sa i përket viteve, vlerat e rreguluara me kalendar janë të barabarta me vlerat sezonale dhe ato të rreguluara sipas kalendarit (përveç dallimeve për shkak të rrumbullakimit).

³ Popullsia mesatare e bazuar në të dhënat e Censusit 2011 dhe përditësimet e popullsisë intercensuale.

(Burimi: Statistisches Bundesamt (Destatis))



(Burimi: Statistisches Bundesamt (Destatis))

Tregtia e jashtme

Eksporti

Mn EURO

Viti muaji		Gjithsej eksporte	Industria e ushqimit (të gjitha së bashku)	Tregti dhe industri			
				Të gjitha së bashku	Lëndë e parë	produkte gjysmë të gatshme	Produkte të gatshme
2023	Korr	126,018	7,362	113,906	812	6,526	106,568
	Qer	138,869	8,060	125,570	978	6,780	117,813
	Maj	131,342	7,925	119,466	1,136	6,585	111,744
	Pri	122,489	7,763	111,607	1,022	6,698	103,887
	Mar	146,301	8,151	135,463	1,259	8,074	126,130
	Shk	132,676	7,955	122,078	1,272	7,507	113,299
	Jan	126,331	7,713	116,392	1,919	7,537	106,936

(Burimi: Statistisches Bundesamt (Destatis))




Importi

Mn EURO

Viti muaji		Gjithsej importe	Industria e ushqimit (të gjitha së bashku)	Tregti dhe industri			
				Të gjitha së bashku	Lëndë e parë	produkte gjysmë të gatshme	Produkte të gatshme
2023	Korr	107,937	8,516	90,426	7,649	7,357	75,421
	Qer	116,639	9,357	97,495	6,814	7,824	82,857
	Maj	117,739	9,950	99,250	8,402	8,082	82,766
	Pri	108,923	9,003	93,055	7,817	8,108	77,131
	Mar	123,740	10,092	106,521	9,504	8,089	88,928
	Shk	115,953	9,903	99,977	9,330	7,580	83,067
	Jan	116,324	9,050	102,403	12,072	8,386	81,945

(Burimi: Statistisches Bundesamt (Destatis))

Shkalla e punësimit



(Burimi: Statistisches Bundesamt (Destatis))

TË ECIM BASHKË!

Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane është organizatë jofitimprurëse e themeluar në Gjermani, në tetor të vitit 2013. Ajo funksionon si shoqatë ombrellë e bizneseve dhe ofron një numër të madh shërbimesh në funksion të zhvillimit të tyre.

Unioni është rrjet i përhershëm i bizneseve dhe shërben si platformë e vazhdueshme për nxitjen dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndërmjet kompanive anëtare, stimulimin dhe lehtësimin e investimeve të jashtme direkte, përmirësimin e qasjes në financa dhe lehtësimin e eksporteve për kompanitë me bazë në Kosovë, përmes krijimit të urave të bashkëpunimit me bizneset e diasporës. Gjatë një dekade të veprimit të tij, Unioni ka arritur rezultate të dukshme si në kuadër të misionit të tij kryesor - nxitjes dhe lehtësimit të bashkëpunimit midis anëtarëve, ashtu edhe në ofrimin e kontributit për zhvillimin ekonomik, mbështetjes humanitare dhe atë të ngritjes së cilësisë së arsimit në vendet e origjinës.

Ne nuk do të ndalemi. Synimi ynë është e kundërta - rritja dhe shpejtimi i hapave. Por, këtë mund ta bëjmë vetëm nëse rritemi edhe vetë ne, sa më shpejtë. Dhe, pikërisht kjo është arsyeja pse ne kemi nevojë edhe për ju. Të ecim bashkë, të rritemi bashkë, të ecim më shpejtë!

Katalogu i përfitimeve të anëtarit

28+
PËRFITIME

	 PREMIUM	 GOLD	 SILBER	 BRONZE
Krijimi i profilit të biznesit në platformë	●	●	●	●
Qasje në profilet e bizneseve anëtare të Unionit	●	●	●	●
Publikimi i projekteve nga anëtarët e Unionit	●	●	●	●
Pjesëmarrje në trajnime dhe punëtori	● x2	●	●	●
Njoftim për mundësitë e investimeve në projekte në vendet e origjinës / publike dhe private	●	●	●	●
Takime PREMIUM – takime mëngjesi/darke i anëtarëve Premium	●	●	●	●
Konsulencë ligjore në fushën e investimeve, rreth tatimeve dhe për investime përmes PPP (Kosovë)	●	●	●	●
Mundësi aplikimi për fonde investimi	●	●	●	●
Njoftim i vazhdueshëm me risitë në politikat fiskale dhe ekonomike në vendlindje	●	●	●	●
Partneritet midis anëtarëve për investime të përbashkëta (konzorcium, shoqëri aksionare etj.)	●	●	●	●
Adresim i çështjeve të veçanta të investitorëve, anëtarë të Unionit, pranë institucioneve shtetërore	●	●	●	●
Lobim tek institucionet shtetërore për ndryshimin e ligjeve apo politikave fiskale	●	●	●	●
Ndihmë në identifikimin e bashkëpunëtorëve potencial / lehtësim në krijimin e lidhjes	●	●	●	●
Mundësi aplikimi për projekte investimi	●	●	●	●
Njoftim për mundësitë e marrjes së granteve nga institucionet shtetërore dhe organizatat e huaja	●	●	●	●
Qasje në raportet vendore e ndërkomb. për ekonominë dhe të bërit biznes në vendlindje (publikim)	●	●	●	●
Vizita të organizuara në panairë	● x2	●	●	●
Ofertë për bashkëpunim nga anëtarët e Unionit	●	●	●	●
Pjesëmarrje në takime B2B (Business to Business)	● x2	●	●	●
Njoftim për aktivitetet që organizohen nga partnerët e Unionit	●	●	●	●
Ndihmë teknike për vetorganizimin e aktiviteteve me anëtarë të caktuar të Unionit	●	●	●	●
Reklamim i bizneseve anëtare në platformën digjitale dhe rrjetet sociale të Unionit	●	●	●	●
Info. dhe statistika rreth indikatorëve makroekonomik, eksport-import dhe investimeve të jashtme	●	●	●	●
ANËTARI PËR ANËTARIN (anëtar i Unionit përfiton zbritje nga anëtarët e tjerë)	●	●	●	●
PRIVILEGJI I ANËTARIT (Oferta speciale për anëtarë nga marrëveshjet që lidh Unioni me subjektet e treta ekonomike)	●	●	●	●
Marrja e referencave bazuar në performancën në platformë	●	●	●	●
Mundësi për t'u bërë/për të gjetur distributor/agjent tregtar	●	●	●	●
Pjesëmarrje në bashkëbisedim me personalitete të rëndësishme	●	●	●	●

ARSYET PËR TË INVESTUAR NË KOSOVË

Për kompanitë që kërkojnë të investojnë në një vend me shpenzime të vogla e me qasje të lehtë në BE, në Evropën Qendrore dhe në tregjet e Ballkanit, Kosova paraqet një mundësi shumë atraktive.

Në Kosovë, një investitor mund të regjistrojë biznesin për 2 ditë, falas me zero kapital çarter (për SHPK-të).

Regjimi i tregut të lirë

- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) me Bashkimin Evropian (BE);
- Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me BE-në (mbi 500 milion konsumatorë);
- Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me Evropën Qendrore (CEFTA) (përfshinë 7 vendet jo-anëtare të BE-së: Shqipërinë, Bosnjë dhe Hercegovinën, Kosovën, Maqedoninë e Veriut, Moldavinë, Malin i Zi dhe Serbinë - popullsia: 21 milion);
- Programi i Sistemit të Gjeneralizuar të Preferencave (Generalized System of Preferences (GSP) Program) me SHBA-në, Japoninë dhe Norvegjinë.

Kosto e ulët e operimit

- Paga mesatare bruto në sektorin privat është 473 €;
- TVSH: 8% për produktet bazë (shërbimet dhe shporta e ushqimit) dhe 18% për produktet tjera;
- Tatimi në dividendë: 0%
- Liberalizimi i importit:
 - Linjat e prodhimit dhe pajisjet për prodhim
 - Lënda e parë për prodhim (që nuk prodhohet në Kosovë)
 - Pajisjet e teknologjisë informative (TI);
- Sistemi Elektronik i Prokurimit
- Tatimi në të Ardhurat e Korporatave: 10%
- Tatimi mbi të Ardhurat Personale: 0 - 10 % (progresive)
- Kontributi pensional i detyruar: 5%

Sektorët që ofrojnë më shumë mundësi për investitorët e jashtëm janë:

- Bujqësia dhe Përpunimi i Ushqimit
- Përpunimi i drurit
- Ndërtimi
- Tekstili
- TI
- Komponentët e automobilave
- Turizmi
- Energjia dhe minierat

(Burimi: KIESA dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës)

Profili i anëtarëve

Shërbime	49.49 %
Ndërtimtari	36.03 %
Gastronomi	5.72 %
Tregti	2.69 %
Prodhim	2.02 %
Financa	2.02 %
Shëndetësi	1.35 %
Veshmbathje	0.67 %

Zotimi i bordit

“Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane do të jetë një urë e sigurt dhe një zë i fortë për anëtarët tanë, si në procesin e bashkëpunimit midis tyre, ashtu edhe në përfaqësimin e tyre në institucione, shoqata dhe kompani, në Gjermani dhe në vendet tona të origjinës”.



UNION BUSINESS
Albanisch & Deutsch

ZYRA QENDRORE - GJERMANI

Tel. +49 (0) 211 88 250 220, +49 152 247 562 80
info@union-business.de, www.union-business.de

ZYRA NË KOSOVË

Tel. +383 48 735 734



“Për ta kryer një punë të vështirë unë zgjedh një person dembel. Sepse, dembeli do ta gjejë mënyrën më të lehtë për ta bërë atë”.

Bill Gates



Paçi shëndet dhe suksese, në punë e në jetë!